



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 19 prill 2011

**Hapje zyrtare e Stacionit të inspektoratit kufitar veterinar fitosanitar  
në pikën kufitare Tabanovc**

Tabanovc  
prill 2011

Fjalim i

Ambasadorit  
z. Piter SØRENSEN  
Shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian

I nderuar Zëvendëskryeministër Stavrevski; i nderuar Ministër Dimovski; i nderuar Drejtor Runtevski, i nderuar Drejtor Stamenov, zonja dhe zotëri;

Kam nderin të ju përshëndes dhe ta përuroj sot hapjen zyrtare të Stacionit të ri të inspektoratit kufitar veterinar dhe fitosanitar në Tabanovc.

Sot jemi duke e hapur stacionin kufitar bashkëkohorë veterinar dhe fitosanitar i cili do ti përmirësoj kushtet për punë në këtë pikë më frekvente kufitare dhe do ti mundëson inspektorëve kufitarë veterinar dhe fitosanitar ti përmbushin detyrat e tyre të ditëpërditshme në pajtueshmëri me kushtet e BE-së.

Dizajni për këto tre objekte ishte i përgatitur nga projektet të financuara nga BE/CARDS ndërsa plani ka qenë i aprovuar nga Zyra për ushqim dhe veterinë pranë Komisionit Evropian, fakt i cili garanton se objektet janë të ndërtuar në pajtueshmëri me standardet evropiane.

Vlera e investimit është 1,35 milion euro. Është siguruar nga programi CARDS (2006). Objektet kanë qenë të ndërtuar në periudhë 13 mujore (prej 22 dhjetor të vitit 2009 deri më 22 janar të vitit 2011)

Kjo është stacioni i tretë kufitar për inspektim veterinar e fitosanitar i ndërtuar nga fondet e BE-së. Dy të tjerët janë në Bogodrociçë dhe në Mexhitli.

Është esenciale që rrjeti i stacioneve të inspektimeve kufitare janë tërësisht efikase për mbrojtjen nga rreziqet potenciale nga importimeve mbi shëndetin publik, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve.

Importimi i kafshëve të gjalla dhe të prodhimeve me origjinë të kafshëve paraqesin rrezikun më të lartë pasi që ata mundën të përhapin sëmundje serioze njerëzore dhe të kafshëve. Kontrollimi kufitarë veterinarë paraqet faktorë kryesorë për të siguruar se kafshët e gjalla dhe prodhimet me origjinë të kafshëve të cilat hynë në vend janë të sigurt dhe i plotësojnë kushtet specifike për import dhe janë në përputhshmëri me legjislacionin.

Shtetet gjithashtu duhet të sigurojnë barriera të besueshme kundër hyrjes së insekteve të dëmshme, në mënyrë që mallrat të cilat kalojnë në stacionin kufitarë për inspektim veterinar dhe fitosanitarë janë të pranuar me besim.

Në vitin e kaluar, vend i juaj ka arritur progres të mirë në sektorin veterinarë dhe sigurimin e ushqimit, kryesisht në procesin e përafrimit ligjorë me miratimin e Ligjit të ri për sigurinë e ushqimit (dhjetor të vitit 2010) dhe me formimin e Agjencisë për ushqim dhe veterinë (1 janar të vitit 2011). Sidoqoftë, kapacitetet administrative në këtë sektorë akoma kërkon forcime.

Bashkimi Evropian ka ndërmarr dhe do të vazhdoj të ndërmerr qasje proaktive si për përgatitjen për pranim, ashtu edhe për monitorimin e progresit.

Ne sigurojmë ndihmë teknike për harmonizimin e ligjeve me legjislacionin e BE-së dhe për ti ndërtuar kapacitetet për implementimin dhe zbatimin e ligjeve. Për momentin në disponim janë 3 milion euro për ndihmë teknike dhe projekte për furnizim për Agjencinë e ushqimit dhe veterinars dhe ndihmë plotësuese financiare prej 5,1 milion euro për dy vitet e ardhshme në kuadër të programit IPA.

Pra, përderisa përfitimet nga anëtarësimi në BE janë të rëndësishme, me atë anëtarësim vinë edhe përgjegjësitë, të cilat duhet të vazhdojnë që të ruhet integriteti i mekanizmave për sigurinë e ushqimit në kuadër të Bashkimit Evropian. Për këtë arsye ne e ndihmuam këtë stacion kufitar për inspektim veterinar dhe fitosanitar.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj.